



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 4 dhe 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, duke vendosur sipas kërkesës Nr.5-400-56406 të dates 13.11.2020 të OJQ-së "HOPE" nga Lipjani, Kryetari i Komunes nxjerr:

## VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

### Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 490 € (katërqind e nëntdhjetë euro), OJQ-së "HOPE" nga Lipjani, sipas kërkesës së tyre Nr.5-400-56406 të dates 13.11.2020, për ta mbështetur financiarisht për realizimin e projektit "Me maskë e distance kundër COVID-19" i cili përojeket ka për qëllim vetëdijsimin për mbrojtje nga pandemia.

### Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020 pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në xhironlogarinë bankare të OJQ-së "HOPE" në nr. 1501080002552774 në Raiffeisen Bank.

### Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara i lartëcekuri duhet të sjell dëshmi deri në shumën e lejuar dhe të njëjtat ti dorëzojë në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport më së largu me datë 03.03.2021.

### Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet OJQ-së "HOPE" nga Lipjani.

1Nr. 400-56406  
Lipjan, më 18.11.2020

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti

